



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.09, datë 16.03.2017

Për

***“Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016”*”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 16.03.2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimet Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, në kuadër të shqyrtimit të “Ankim administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi Altelecom Sh.a., depozituar në AKEP me shkresë Nr. 422 Prot, datë 20.02.2017 (Nr. 371 Prot., AKEP datë 23.1.2017) me objekt:

- Ndryshimin e Vendimit nr.2703, datë 22.12.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP për *“Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Perfundimtar”* për ndryshimin e përmbajtjes së dokumentit për Rregullimin e tarifave në lidhje me nivelin e tarifave për shërbimet e LLU-së dhe bitstream si dhe derregullimin e tarifave të linjave me qira;
- Ndryshimin e Vendimit nr.2704, datë 22.12.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP për *“Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Altelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira”*, për ndryshimin e pikës 1.a, tabela 1, pikës 2.a, Tabela 3, pikës 2.b) të Vendimit në lidhje nivelin e tarifave të LLU-së dhe

*bitstream* si dhe shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit për derregullimin e tarifave të linjave me qira. (Vijim i shqyrtimit të nisur në mbledhjen e KD datë 16.3.2017), shqyrtoi çështjen me objekt:

***Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016”***

### **BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (***ligji nr. 9918***);
2. Ligji nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (***ligji nr. 44/2015***);
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP me nr.2701, datë 22.12.2016, për “*Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*”
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP me nr.2702, datë 22.12.2016, për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira dhe masat përkatëse rregulluese*”

### **K Ë SHILLI DREJTUES:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankim administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi Altelecom Sh.a., depozituar në AKEP me shkresë Nr. 422 Prot, datë 20.02.2017 (Nr. 371 Prot., AKEP datë 23.1.2017) me objekt:
  - Ndryshimin e Vendimit nr.2703, datë 22.12.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP për “*Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar*” për ndryshimin e përmbajtjes së dokumentit për Rregullimin e tarifave në lidhje me nivelin e tarifave për shërbimet e LLU-së dhe *bitstream* si dhe derregullimin e tarifave të linjave me qira;
  - Ndryshimin e Vendimit nr.2704, datë 22.12.2016, të Këshillit Drejtues të AKEP për “*Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Altelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira*”, për ndryshimin e pikës 1.a, tabela 1, pikës 2.a, Tabela 3, pikës 2.b) të Vendimit në lidhje nivelin e tarifave të LLU-së dhe *bitstream* si dhe shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit për derregullimin e tarifave të linjave me qira.
2. Dokumenti “*Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016*”, së bashku me shkresat shoqëruese:

- Shkresa e Albtelecom sh.a me Nr. 422, datë 20.01.2017, (referencë AKEP nr.prot 371, datë 23.01.2017);
  - Shkresa e Albtelecom sh.a me Nr.422/2 Prot., datë 28.02.2017 (Referenca e AKEP: Nr.371/2 Prot., datë 2.03.2017);
3. Relacionin shpjegues mbi trajtimin e çështjes të paraqitur nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim (**Relacioni**);
  4. Projekt-Aktin vendimmarrës të Këshillit Drejtues në përfundim të shqyrtimit të Dokumentit, të rekomanduar nga struktura e ngarkuar për trajtimin e çështjes;

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### V Ë R E N:

1. AKEP me VKD nr.2703, datë 22.12.2016, miratoi Dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar*”.
2. Dokumenti i sipërcituar, shërbeu si pjesë arsyetuese për marrjen e Vendimit nr.2704, datë 22.12.2016, për rregullimin e tarifave të Albtelecom sh.a i përcaktuar me FNT me VKD Nr.2702, datë 22.12.2016.
3. Miratimi i këtyre dokumenteve u krye pas procesit të këshillimit publik, gjatë së cilit AKEP mori në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara.
4. Albtelecom me shkresën me Nr. 422, datë 20.01.2017, (referencë AKEP nr.prot 371, datë 23.01.2017), ka ankimuar në rrugë administrative vendimet nr.2703 dhe 2704, datë 22.12.2016. Ankimi i Albtelecom është kryer brenda afateve të përcaktuara nga Kodi i Proçedurave Administrative. Kërkesat dhe argumentat kryesore të Albtelecom për ndryshimin e vendimeve të cituara janë si më poshtë:
  - VKD nr.2704 për “*Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira*”, duke kërkuar nga AKEP ndryshimin e pikës 1.a, pikës 2.a, Tabelës 3, pikës 2.b të Vendimit në lidhje me nivelin e tarifave të LLU dhe Bitstream si dhe shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit për derregullimin e tarifave të linjavë me qera;
  - VKD nr.2703 për “*Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar*” duke kërkuar nga AKEP ndryshimin e përmbajtjes së dokumentit për rregullimin e tarifave me nivelin e tarifave për shërbimet LLU dhe Bitstream si dhe derregullimin e tarifave të linjavë me qera.
5. Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 16.02.2017, sipas rendit të ditës mori në shqyrtim ankimin administrative të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a, dhe në mbështetje të nenit 136 të ligjit nr. 44/2015, Këshilli Drejtues, vlerësoi se:
  - a. Ankimi është i pranueshëm dhe se duhet ti japë mundësinë Ankimuesit që të paraqesë prova, dokumente, vlerësime apo komente me qëllim në arritjen e rezultateve

- përfundimtare për marrjen e vendimit përfundimtar nga AKEP, lidhur me ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar.
- b. Të pranohet shqyrtimin e ankimit administrativ të paraqitur nga sipërmarrësi Altelecom Sh.a., depozituar në AKEP me shkresë Nr. 422 Prot, datë 20.02.2017 (Nr. 371 Prot., AKEP datë 23.1.2017).
  - c. Të kryhen hetime administrative shtesë nga struktura e ngarkuar në AKEP për trajtimin e çështjes duke i kërkuar ankimuesit që brenda datës 28.02.2017 të depozitojnë në AKEP nëse kanë dokumenta, prova ose argumenta të tjera përveç atyre të depozituara në ankim.
  - d. Në përfundim të procedurës sipas nenit 136 të ligjit nr.44/2015 dhe përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9918, lidhur me trajtimin e thelbit të çështjes dhe procesin e këshillimit publik, struktura e ngarkuar për trajtimin e çështjes të paraqesi brenda afatit ligjor, në mbledhjen e Këshillit Drejtues, praktikën dokumentare për shqyrtim lidhur me ankimin.
6. AKEP me shkresën nr.371/1 Prot., datë 20.02.2017 njoftoi Altelecom për vlerësimin e ankimit të dërguar prej tij dhe Altelecom me shkresën Nr.422/2 Prot., datë 28.02.2017 (Referenca e AKEP: Nr.371/2 Prot., datë 2.03.2017), ka dërguar argumenta shtesë për ankimin për tarifën e LLU dhe aksesit bitstream.
  7. Struktura përkatëse e AKEP pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe argumentet e Altelecom sh.a të dërguara me shkresat e cituara më sipër ka përgatitur dokumentin *“Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016”*.
  8. Dokumenti *“Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016”* përmban propozimin e AKEP për rishikimin e tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me vendimet nr.2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, dhe përbën një rivlerësim vetëm të pjesëve të dokumentit
  9. Dokumenti *“Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016”*, përmban një diskutim mbi tarifën e LLU dhe aksesit Bitstream të Altelecom të përcaktuara në vendimet 2703 dhe 2704, përfshirë arsyetimin përdorur në dokumentin *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar”*(miratuar me VKD 2703/2016) si dhe propozimin e Altelecom për rishikim të këtyre tarifave dhe vlerësimin e AKEP. Dokumenti ka si objekt vetëm rishikimin e tarifave të LLU dhe aksesit bitstream, ndërsa tarifën e tjera të miratuara me Vendimet 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, konsiderohen finale dhe të aplikueshme sipas përcaktimeve të akteve të cituara.
  10. Bazuar në përcaktimet e Ligjit nr.44/2015 dhe përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9918, dokumenti *“Rishikimi i tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016”*, nxirret për këshillim publik me palët e interesuara.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenin 146, të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 110 të ligjit nr. 9918,

## V E N D O S:

1. Miratimin për këshillim publik të dokumentit “*Rishikimi i tarifave te aksesit bitstream dhe LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016*” sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Periudha e këshillimit publik të jetë 17.03.2017-17.04.2017.
3. Të njoftohet sipërmarrësi Albtelecom sh.a. dhe palët e interesuara për procesin e këshillimit publik.
4. Ky vendim dhe dokumenti i miratuar në pikën 1 më sipër të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Rishikimi i tarifave te aksesit bitstream dhe  
LLU të miratuara me Vendimet e Këshillit  
Drejtues të AKEP me nr. 2703 dhe 2704, datë  
22.12.2016**

**Dokument për Këshillim Publik**

**Miratuar me VKD nr.9, datë 16.03.2017**

## Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrje .....	3
2.	Procesi i rregullimit të tarifave të aksesit LLU dhe bitstream .....	5
	2.1. Tarifat sipas analizave të mëparshme të tregut .....	6
	2.1. Ndryshimet në versionin e Këshillimit Publik dhe Versionin Final 2016 .....	8
	Tarifat për LLU .....	8
	Tarifat për aksesin bitstream (Tregu WCA) .....	8
	2.3. Argumenta të Albtelecom për tarifën e LLU dhe aksesin bitstream .....	10
3.	Rishikimi i tarifave të aksesit LLU dhe bitstream të Albtelecom .....	14
	Aneks 1: Pyetjet e këshillimit publik .....	17

## Lista e Tabelave dhe Figurave

TABELA 1: TARIFAT E AKSESIT NË RRJETIN LOCAL LLU TË ALBTELECOM (2014) .....	6
TABELA 2: METODA E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË AKSESIT BITSTREAM TË ALBTELECOM (2014) .....	6
TABELA 3: TARIFAT MUJORE TË AKSESIT BITSTREAM TË ALBTELECOM (TETOR 2016) .....	7
TABELA 4: TARIFAT PËR AKSESIN LLU: KËSHILLIM PUBLIK DHE FINALE .....	8
TABELA 5: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE TË AKSESIT BITSTREAM TË ALBTELECOM (2016-) .....	8
TABELA 6: TARIFAT MAKSIMALE MUJORE TË AKSESIT BITSTREAM TË ALBTELECOM (1.07.2017-) .....	9
TABELA 7: NDRYSHIMI I TARIFAVE MAKSIMALE TË AKSESIT BITSTREAM VERSIONI FINAL-KËSHILLIM PUBLIK .....	10
TABELA 8: TARIFAT MUJORE TË AKSESIT BITSTREAM TË ALBTELECOM (TETOR 2016 DHE 1.07.2017) .....	14
TABELA 9: TARIFAT PËR AKSESIN LLU: TETOR 2016 DHE 1.07.2017 .....	14

# 1. Hyrje

---

AKEP me VKD nr.2701, datë 22.12.2016, miratoi Dokumentin “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar”, i cili shërbeu si bazë arsyetuese për VKD nr. 2702, datë 22.12.2016 për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me status me FNT në tregjet përkatës të analizuar si dhe për vendosjen e e masave rregulluese për FNT. Miratimi i këtyre vendimeve dhe dokumenteve u krye pas procesit të këshillimit publik, gjatë të cilit AKEP mori në konsideratë komentet e dërguara nga palët e interesuara. Paralelisht me procesin e këshillimit publik për analizën e tregut, FNT dhe masat rregulluese, AKEP kreu një proces të vecantë këshillimi publik për “*Rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse*” për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës dhe modalitetet e tjera të rregullimit të këtyre tarifave. AKEP me Vendimin nr.*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira-Këshillim Publik*”, si dhe të këtij dokumenti të nxjerrë në këshillim publik.

AKEP me VKD nr.2703, datë 22.12.2016, miratoi Dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar*” dhe bazuar në këtë dokument me VKD nr.2704, date 22.12.2016 miratoi metodën dhe nivelet përkatëse të tarifave të shërbimeve me shumicë të Albtelecom për të cilat u shpall me FNT nëpërmjet VKD nr.2702, datë 22.12.2016.

Albtelecom ankimoi katër vendimet 2701-2704, datë 22.12.2017 dhe KD nuk pranoi ankimin e Albtelecom për vendimet nr.2701 dhe 2702, datë 22.12.2016 në lidhje me analizën e tregut dhe e FNT të Albtelecom, ndërsa në lidhje me ankimin për rregullimin e tarifave (të aksesit bitstream dhe LLU), AKEP pranoi ankimin e Albtelecom, duke vendosur për një thellim të hetimit administrativ, përfshirë këshillim me palët e interesuara të rishikimit të rregullimit të tarifave të LLU dhe aksesit bitstream të përcaktuara me vendimet 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016.

Ky dokument që nxirret në keshillim publik, përmban nje diskutim mbi tarifat e LLU dhe aksesit Bitstream të ALbtelecom të percaktuara në vendimet 2703 dhe 2704, përfshirë arsyetimin përdorur në dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti*



*Përfundimtar*” si dhe propozimin e Albtelecom për rishikim të këtyre tarifave dhe vlerësimin e AKEP.

Dokumenti ka si objekt vetëm rishikimin e tarifave të LLU dhe aksesit bitstream, ndërsa tarifat e tjera të miratuara me Vendimet 2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, konsiderohen finale dhe të aplikueshme sipas përcaktimeve të akteve të cituara.

## 2. Procesi i rregullimit të tarifave të aksesit LLU dhe bitstream

---

AKEP me Vendimin nr.2682, date 7.07.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse – Këshillim Publik*” për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës dhe modalitetet e tjera të rregullimit të këtyre tarifave.

Procesi i këshillimit publik të këtij dokumenti përfundoi me datë 15 Shtator 2016 dhe AKEP me Vendimin nr.2703, datë 22.12.2016 miratoi dokumentin “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar*”, dhe bazuar në përfundimet e këtij dokumenti, KD i AKEP me Vendimin nr.2704, datë 22.12.2016, miratoi metodën dhe tarifat përkatëse për shërbimet me shumicë të Altelecom, i përcaktuar me FNT me Vendimin nr.2702, datë 22.12.2016.

Altelecom me shkresën me Nr. 422, datë 20.01.2017, (referencë AKEP nr.prot 371, datë 23.01.2017), ka ankimuar në rrugë administrative Vendimet nr.2703 dhe 2704, datë 22.12.2016, duke kërkuar rishikimin e tarifave të LLU dhe aksesit bitstream të miratuar me këto vendime. Në vijim të përgjigjes së AKEP për pranimin e kërkesës për rishikim të tarifave të shërbimeve të cituara, Altelecom me shkresën Nr.422/2 Prot., datë 28.02.2017 (Referenca e AKEP: Nr.371/2 Prot., datë 2.03.2017), ka dërguar argumenta shtesë për ankimin për tarifat e LLU dhe aksesit bitstream.

Në vijim AKEP ka paraqitur metodën dhe tarifat e LLU dhe aksesit bitstream:

- të miratuar në analizat e mëparshme të tregut,
- të propozuara nga AKEP në dokumnetin e nxjerrë në këshillim publik me 7.07.2016 dhe në dokumentin përfundimtar me 22.12.2016 dhe ndryshimi midis tyre, si dhe
- argumentat dhe propozimet kryesore të Altelecom për këto tarifa, përfshirë ato të dërguara së fundmi më datë 28.02.2017.

## 2.1. Tarifatat sipas analizave të meparshme të tregut

### Tarifatat e Albtelecom për LLU

Në lidhje me tarifatat për LLU, AKEP në analizën e tregut 2014 vendosi që Albtelecom të aplikojë tarifatat e miratuara me VKD nr.1365, datë 13.04.2011, duke saktësuar që për linjat e aksesuara në MSAN për LLU, Albtelecom të aplikojë tarifatat përkatëse të aksesit (të plotë dhe të përbashkët) në **nën-rrjetin lokal**. Metoda e zgjedhur ishte aplikimi i tarifave maksimale, sipas rezultateve të modelit të kostove BULRAIC në vitin 2010.

**Tabela 1: Tarifatat e aksesit në rrjetin lokal LLU të Albtelecom (2014)**

Shërbimi	Tarifa (Lekë)	Njësia
Pagesa mujore për LLU		<b>Paguhet çdo muaj</b>
Akses i plotë në rrjetin lokal	<b>801</b>	[për linjë]
Akses i përbashkët në rrjetin lokal	<b>468</b>	[për linjë]
Akses i plotë në nën-rrjetin lokal	<b>678</b>	[për linjë]
Akses i përbashkët në nën rrjetin lokal	<b>407</b>	[për linjë]
Pagesa instalimi për LLU		<b>Paguhet vetëm një</b>
Instalimi i aksesit të plotë në rrjetin	<b>1 686</b>	[për linjë]
Instalimi i aksesit të përbashkët në	<b>2 452</b>	[për linjë]

*Shënim: Tarifatat e mësipërme nuk përfshijnë TVSH*

### Aksesi bitstream

Në lidhje me aksesin bitstream, AKEP në analizën e tregut 2014 vendosi që tarifatat e aplikuar nga Albtelecom për këtë shërbim në nivel ATM/Ethernet dhe në nivel IP, pra në layer 2 dhe 3 të rrjetit NGN/NGA, të rregullohen me metodën “retail minus”:

**Tabela 2: Metoda e rregullimit të tarifave të aksesit bitstream të Albtelecom (2014)**

Niveli i aksesit	Cmimi Maksimal
Në nivel ATM/Ethernet;	Tarifa Retail - 50%
Në nivel IP	Tarifa Retail - 30%

*Shënim: Tarifa retail me pakicë pa TVSH*

AKEP njëkohësisht vendosi që tarifa për akses bitstream nuk mund të jetë me e lirë se çmimi për akses në LLU. Në vijim të argumentit në pjesën e analizës për LLU, çmimi (tarifa mujore) për akses bitstream nuk mund të jetë më i ulët se 407 lek/muaj.

Albtelecom pas vendimeve të AKEP në vitin 2014 ka publikuar ofertën referencë të aksesit bitstream dhe ka kryer 2 herë rishikim të tarifave duke bërë reduktime deri në 90% të tyre krahasuar me tarifat fillestare. Për shërbimet e aksesit bitstream, Albtelecom ka lidhur marrveshje me 4 operatore në 2014-2015. Pas periudhës së këshillimit publik, Albtelecom në Shtator 2016 ka njoftuar një reduktim tjetër të tarifave të aksesit bitstream, me tarifat e reja që hyjnë në fuqi më 1 Tetor 2016. Reduktimet e muajit Tetor 2016 variojnë nga 7% për aksesin bitstream për shpejtësi 6 Mbps në 17% për aksesin bitstream me shpejtësi 12 dhe 16 Mbps, dhe aplikohen për aksesin në Ethernet dhe IP, për më pak se 100 porta dhe mbi 100 porta. Për shërbimet e aksesit bitstream, Albtelecom ka lidhur marrveshje me 4 operatorë në 2014-2015. Nga të dhënat rezulton se në vitin 2014 Albtelecom ka dhënë akses bitstream operatorëve të tjerë për lidhje me 597 kliente, ndërsa deri në fund të 2015 për 1981 klientë. Tarifat aktuale të aplikuar nga Albtelecom janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 3: Tarifat mujore të aksesit bitstream të Albtelecom (Tetor 2016)**

Shpejtësia Download	Opsioni 1: Bitstream në Ethernet		Opsioni 2: Bitstream në IP	
	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
<b>2 Mbps</b>	468	421	549	494
<b>4 Mbps</b>	623	560	731	658
<b>6 Mbps</b>	766	690	900	810
<b>8 Mbps</b>	1,020	920	1,200	1,080
<b>10 Mbps</b>	1,100	990	1,292	1,163
<b>12Mbps</b>	1,213	1,090	1,425	1,283
<b>16 Mbps</b>	1,395	1,260	1,640	1,470

*Shënim: Tarifat në Lek pa TVSH*

## 2.1. Ndryshimet në versionin e Keshillimit Publik dhe Versionin Final 2016

### Tarifat për LLU

Tabela e mëposhtëme paraqet ndryshimin e tarifave nga niveli Aktual, propozimi në Keshillim Publik (7.07.2016) dhe Versioni final i AKEP (22.12.2016). Nga reduktimi me 28% i propozuar në keshillim publik, AKEP vendosi për reduktim me 18% në versionin final, sipas arsyesimit të përdorur në dokumentin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar”.

**Tabela 4: Tarifat për aksesin LLU: Këshillim Publik dhe Finale**

	Tarifa Aktuale	Dokumenti në Keshillim Publik	Dokumenti Final	Ndryshimi Këshillim/Aktuale	Ndryshimi Final/Aktuale
Tarifa Mujore Akses i plotë në rrjetin local (LLU)-MSAN	678	<b>486</b>	<b>556</b>	-28%	-18%
Akes i përbashkët në rrjetin local (LLU)-MSAN	407	<b>292</b>	<b>334</b>	-28%	-18%
Data e hyrjes në fuqi		<b>1.01.2017</b>	<b>1.07.2017</b>		

*Shënim: Tarifat në LEK pa TVSH*

### Tarifat për aksesin bitstream (Tregu WCA)

Për rregullimin e tarifave të aksesit bitstream, AKEP propozoi në Këshillim publik të vazhdojë rregullimin me metodën ‘Retail minus’ si në vitin 2014 sipas koeficientëve të dhënë në tabelën 2, si dhe vlerave maksimale sipas Tabelës 5 (të njëjta me tarifat e aplikuara nga Altelecom deri në keshillim publik).

**Tabela 5: Tarifat maksimale mujore te aksesit bitstream te Altelecom (2016-)**

Keshillim Publik	
Opsioni 1:	Opsioni 2:
Bitstream në Ethernet	Bitstream në IP

Shpejtësia	deri 100 porta		>100 porta	
	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
<b>2 Mbps</b>	468	421	549	494
<b>4 Mbps</b>	623	560	731	658
<b>6 Mbps</b>	828	745	972	875
<b>8 Mbps</b>	1,101	991	1,293	1,164
<b>10 Mbps</b>	1,266	1,139	1,487	1,338
<b>12Mbps</b>	1,456	1,310	1,710	1,539
<b>16 Mbps</b>	1,675	1,508	1,966	1,769

*Shënim: Tarifat në Lek pa TVSH*

Albtelecom ne Tetor 2016 kreu nje reduktim te tarifave te aksesit bitstream, per shpejtesite 6 mbps dhe siper, te cilat u reflektuan ne dokumentin final te AKEP me 22.12.2016.

Në dokumnetin final, të miratuar më 22.12.2016, AKEP vendosi të hiqte metodën ‘retail minus’ duke përcaktuar vetëm tarifa maksimale dhe/ose minimale për aksesin bitstream, por dhe një reduktim të tarifave maksimale bitstream me 18% nga niveli i Tetor 2016.

**Tabela 6: Tarifat maksimale mujore të aksesit bitstream të Albtelecom (1.07.2017-)**

Dokumenti Final 22.12.2016

Shpejtesia	Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP	
	deri 100	>100	deri 100	>100
<b>2 Mbps</b>	382	345	450	405
<b>4 Mbps</b>	508	459	599	540
<b>6 Mbps</b>	625	566	738	664
<b>8 Mbps</b>	832	754	984	886
<b>10 Mbps</b>	898	812	1,059	954
<b>12Mbps</b>	990	894	1,169	1,052
<b>16 Mbps</b>	1,138	1,033	1,345	1,205

Vlerat e mësipërme u përcaktuan duke aplikuar formulën “Retail-50%” për tarifën me pakicë të Albtelecom për ‘i+fix 1499’ me shpejtësi doëload 6 Mbps, si paketa me përfaqësuese në tregun me pakicë të aksesit broadband, ku tendenca është për përdorim të lartë të paketave bundle dhe me shpejtësi aksesi broadband më të përdorur në nivelet 4-10 Mbps. Versioni final i miratuar me 22.12.2016 imponon një reduktim me 18% të tarifave bitstream nga niveli i Tetor 2016, por një reduktim me 18-32% nga Versioni i Këshillimit Publik, sipas tabelës së mëposhtëme:

**Tabela 7: Ndryshimi i tarifave maksimale të aksesit bitstream Versioni Final-Keshillim Publik**

	Opsioni 1: Bitstream në Ethernet		Opsioni 2: Bitstream në IP	
	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
<b>2 Mbps</b>	-18%	-18%	-18%	-18%
<b>4 Mbps</b>	-18%	-18%	-18%	-18%
<b>6 Mbps</b>	-25%	-24%	-24%	-24%
<b>8 Mbps</b>	-24%	-24%	-24%	-24%
<b>10 Mbps</b>	-29%	-29%	-29%	-29%
<b>12Mbps</b>	-32%	-32%	-32%	-32%

### 2.3. Argumenta të Albtelecom për tarifat e LLU dhe akses bitstream

Albtelecom në ankimet kundër nivelit të tarifave të LLU dhe aksesit bitstream të miratuara nga AKEP me 22.12.2016 ka kërkuar rishikimin e qendrimit të AKEP për këto tarifa duke marrë në konsideratë ndër të tjera faktorët e mëposhtem:

- *Ndryshimi i madh midis versionit të keshillimit publik dhe versionit final për tarifat e aksesit bitstream.*

Megjithëse Albtelecom në Shtator 2016 kreu një reduktim tjetër të tarifave të aksesit bitstream, AKEP imponoi dhe reduktim shtesë prej 18% mbi këto tarifa tashmë të reduktuara nga vet Albtelecom. Tarifat e aksesit bitstream të miratuara nga AKEP me 22.12.2016 për t'u aplikuar nga Albtelecom duke filluar nga data 1.07.2017 janë deri në 32% më të ulëta se ato të propozuara nga AKEP në keshillim publik.

- *Perdorimi i shërbimeve bitstream, kërkesat e operatorëve në vite në Albtelecom, dhe mosmarreveshje të mundshme midis operatorit ofrues dhe kërkuarit të aksesit bitstream*

Që prej vitit 2014 e në vazhdim, Albtelecom ka treguar kohë pas kohe vullnetin dhe dëshirën e tij për nxitje të përdorimit të shërbimit Bitstream dhe ka kryer rishikim dhe reduktim të tarifave Bitstream dy herë, në Korrik 2015 dhe në Shtator 2016. Aktualisht Albtelecom ka 5 kontrata të

nënshkuara me operatorët, ku në total për të gjitha kontratat janë në funksionim rreth 2400 linja që ofrohet shërbimi i internetit për abonentin nëpërmjet bitstream. Albtelecom në cdo rast ka qënë i hapur dhe i gatshëm për bashkepunim me operatorët kërkues, gjë që dëshmohet qartë dhe nga fakti se në këtë proces negociimi dypalësh për nënshkrimin e kontratave të shërbimit Bitstream, tek AKEP në asnjë rast nuk është adresuar nga operatorët kërkues ndonjë kërkesë për zgjidhje mosmarreveshjeje. Tabela e mëposhtme pasqyron tarifat e Albtelecom për shërbimin Bitstream nga viti 2014 e në vazhdim, si dhe reduktimin e tyre të kryer në Korrik 2015 dhe Shtator 2016:

Periudha	Qershor 2014		Korrik 2015		Shtator 2016		Ndryshimi Korrik 2015 vs Qershor 2014		Ndryshimi Shtator 2016 vs Korrik 2015	
	Opsioni 1: Bitstream Ethernet level	Opsioni 2: Bitstream IP level	Opsioni 1: Bitstream Ethernet level	Opsioni 2: Bitstream IP level	Opsioni 1: Bitstream Ethernet level	Opsioni 2: Bitstream IP level	Bitstream Ethernet level	Bitstream IP level	Bitstream Ethernet level	Bitstream IP level
Nr.portave	deri 100 porta		deri 100 porta		deri 100 porta		(in %)	(in %)	(in %)	(in %)
2 Mbps	611	692	468	549	468	549	-23%	-21%		
4 Mbps	866	981	623	731	623	731	-28%	-25%		
6 Mbps			828	972	766	900			-7%	-7%
8 Mbps	1,225	1,389	1,101	1,293	1,020	1,200	-10%	-7%	-7%	-7%
10 Mbps			1,266	1,487	1,100	1,292			-13%	-13%
12 Mbps	1,498	1,698	1,456	1,710	1,213	1,425	-3%	1%	-17%	-17%
16 Mbps	1,732	1,963	1,675	1,966	1,395	1,640	-3%	0%	-17%	-17%

***- Instrumentat Rregullatore të përdorur dhe ndryshimet e mundshme në politikat rregullatore që kanë ndodhur apo planifikohet të ndodhin***

Albtelecom thekson faktin se ka bërë reduktim të tarifave edhe në muajin Shtator 2016, dhe AKEP duhet të veprojë duke përcaktuar tarifat maksimale ose minimale sipas nivelit të ri të tarifave të reduktuara nga vet Albtelecom në Shtator 2016, i cili përbën dhe një reduktim me 7-17% nga niveli propozuar i AKEP në Këshillim publik.

Albtelecom e mirekupton marrjen në konsideratë të tarifës me pakicë të paketës i+Fiks 1499 si të pranueshme, sa kohë që dhe shpejtësia mesatare e paketave të zgjedhura nga abonentet është rreth 6 Mbps. Por, aplikimi i skontos prej 50% për aksesin bitstream në nivel Ethernet është jo-proporcional nëse merren në konsideratë inputet e përdorura nga Albtelecom për të mundësuar



ofrimin e shërbimit deri në këto nivel, apo inputet që duhet të shtojë operatori kërkues i shërbimit për të ofruar një produkt të ngjashëm me atë të Albtelecom.

Për më tepër kur, përdorimi i këtyre paketave "i+Fiks" edhe për abonentin me pakicë të Albtelecom është thujse vetëm internet, dhe interesi për thirrjet telefonike që përfshihen në këto paketa është minimal, c'ka është e evidente nga të dhënat e trafikut on-net të Albtelecom (trafikun që ofrohet brenda paketave i-fiks) i cili ka vetëm trend zbritës nga viti në vit, duke shënuar 18% më pak për 2016 krahasuar me vitin 2015. Për këto arsye, **Albtelecom propozon një normë me të arsyeshme skontimi jo më të lartë se 40%**, për tu aplikuar për përfitimin e tarifës me shumicë për internet 6 Mbps.

Duke aplikuar arsyetimin e AKEP me normën e skontos 40% mbi tarifën me pakicë "i+Fiks 1499", tarifën e aksesit bitstream do të duhet të reduktohen me 2% nga niveli i tarifave të aplikuar nga Albtelecom duke filluar nga Tetor 2016. Albtelecom shprehet se ky reduktim prej 2% i aplikuar në të gjitha tarifën e aksesit bitstream dhe LLU është me i arsyeshëm dhe në linjë me arsyetimin e AKEP në dokumentin përfundimtar të miratuar me 22.12.2016.

Albtelecom thekson se praktikisht shërbimet bitstream jepen për më shumë se 100 porta, c'ka do të thotë se tarifa me shumicë prej 750 lek/muaj/portë për akses bitstream do të rezultonte 675 lek/muaj/portë (10% discount mbi 100 porta).

***- Zhvillimet e viteve të fundit në tregun me pakicë të aksesit broadband dhe pjesët e tregut të operatorit incumbent Albtelecom***

Futja e produkteve të reja në treg i ka siguruar Albtelecom një pjesë tregu konstante, por është e pamundur të rritet përtej 40% pavarësisht shërbimeve të reja si IPTV, pikërisht për shkak të arritjes së konkurrencës efektive në tregun me pakicë. Për më tepër, të ardhurat e Albtelecom nga shërbimet e komunikimeve elektronike kanë ardhur duke u ulur (reduktim me 6% në Vitin 2015 krahasuar me Vitin 2014) dhe po ashtu EBITDA.

Në këtë situatë, Albtelecom mendon se cdo reduktim i mëtejshëm i tarifave të shërbimeve të rregulluara dhe konkretisht i tarifave të Bitstream nuk është i justifikuar. Prandaj dhe pritshmëria që ka Albtelecom në këtë rast nga AKEP, është jo më shumë se sanksionimi i cmimit maksimal

mujor për tarifat bitstream sipas tarifave të njoftuara operatorëve nga Albtelecom në Shtator 2016, me një reduktim jo më të lartë se 2%.

- ***Kthimi kundrejt nivelit të investimit në rrjetin NGN të operatorit Albtelecom***

Albtelecom ka ndërmarrë investime të konsiderueshme me miliona Euro në vite për ngritjen e rrjetit NGN për të zgjeruar gamen e shërbimeve që ofron në treg dhe për të rritur cilësinë e tyre, dhe njëkohësisht duke plotësuar detyrimet ligjore në lidhje me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, sigurinë kombëtare etj. Madje i gjithë ky investim i Albtelecom është çenuar shpesh për shkak të dëmtimeve të shumta të infrastrukturës së rrjeteve urbane dhe inter-urbane të cilat Albtelecomit i është dashur t'i rekuperojë me shpenzimet e veta, apo për shkak të pengesave të vazhdueshme dhe zvarritjeve disa vjecare për marrjen e lejeve të ndryshme për formalizimet e shtrirjes së rrjeteve.

Për rrjedhojë, i gjithë ky investim i Albtelecom nuk ka mundur akoma të shfrytëzohet dhe gëzohet nga vetë Albtelecom për shërbimet e tij dhe aq më pak të arrihet kthimi nga investimi i bërë, ndaj dhe e gjejme si jo-proporcionale dhe jo të arsyeshme të reduktohen ndjeshëm tarifat e shërbimeve të rregulluara, veçanërisht tarifat për shërbimet bitstream, sa kohë që tregu nuk paraqet problematika.

- ***Rregullimi i tarifave të shërbimit bitstream në vendet e EU-së***

Albtelecom duke i'u referuar të dhënave nga Cullen International informon se deri në Tetor 2016, 14 nga 32 vende të BE/Rajonit pra rreth 44% e tyre nuk aplikojnë rregullim të tarifave Bitstream.

### 3. Rishikimi i tarifave të aksesit LLU dhe bitstream të Albtelecom

AKEP bazuar në argumentat shtesë të ALbtelecom, parashikimet e Ligjit të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të Ligjit 9918, vlerëson të arsyeshme që të rishikojë nivelin e tarifave të aksesit në LLU dhe aksesit bitstream, të përcaktuara në dokumentin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar”, për t’u aplikuar nga Albtelecom duke filluar nga data 1.07.2017 si më poshtë:

**Tabela 8: Tarifat mujore të aksesit bitstream të Albtelecom (Tetor 2016 dhe 1.07.2017)**

	Tarifat 1.10.2016				Tarifat 1.07.2017				Ndryshimi			
	Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP		Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP		Opsioni 1: Bitstream ne Ethernet		Opsioni 2: Bitstream ne IP	
	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta	deri 100 porta	>100 porta
<b>2 Mbps</b>	468	421	549	494	458	412	537	484	-2.1%	-2.1%	-2.1%	-2.1%
<b>4 Mbps</b>	623	560	731	658	610	548	716	644	-2.1%	-2.1%	-2.1%	-2.1%
<b>6 Mbps</b>	766	690	900	810	750	676	881	793	-2.1%	-2.1%	-2.1%	-2.1%
<b>8 Mbps</b>	1,020	920	1,200	1,080	999	901	1,175	1,057	-2.1%	-2.1%	-2.1%	-2.1%
<b>10 Mbps</b>	1,100	990	1,292	1,163	1,077	969	1,265	1,139	-2.1%	-2.1%	-2.1%	-2.1%
<b>12Mbps</b>	1,213	1,090	1,425	1,283	1,188	1,067	1,395	1,256	-2.1%	-2.1%	-2.1%	-2.1%
<b>16 Mbps</b>	1,395	1,260	1,640	1,470	1,366	1,234	1,606	1,439	-2.1%	-2.1%	-2.1%	-2.1%

Shënim: Tarifat në Lek pa TVSH

**Tabela 9: Tarifat për aksesin LLU: Tetor 2016 dhe 1.07.2017**

	Tarifa 1.10.2016	Tarifat 1.07.2017	Ndryshimi
Tarifa Mujore Akses i plotë në rrjetin local (LLU)-MSAN	678	664	-2.1%
Akes i përbashket në rrjetin local (LLU)-MSAN	407	398	-2.1%

Shënim: Tarifat në LEK pa TVSH

Rishikimi i mësipërm është bazuar në arsyetimin e përdorur nga AKEP në seksionin 4.1 të dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar”,

por në vend të aplikimit të skontos 50% mbi tarifën me pakicë të paketës “i+fixs 1499” është përdorur skonto prej 40%. Kjo con në reduktim prej 2.1% të nivelit të tarifave të Altelecom për LLU dhe bitstream në fuqi që prej 1 Tetor 2016. AKEP vlerëson se niveli i ri tarifave me shumicë të propozuara është i arsyeshëm:

- Reduktimi prej 18% nga niveli i tarifave të Tetor 2016 i përcaktuar nga AKEP në vendimet e datës 22.12.2016 përbënte një reduktim të ndjeshëm dhe jo-proporcional prej 18-32% nga niveli i tarifave të propozuar në këshillim public më 7.07.2016;
- Niveli i ri i propozuar nëpërmjet këtij dokumenti është në linjë me rregullimin për tarifat e shërbimeve të tjera si akses në tubacione dhe linjat me qira me shumicë të Altelecom dhe vlerësohet se krijon stimujt e duhur për përdorimin edhe të këtyre shërbimeve të tjera me shumicë. Imponimi nga AKEP i një reduktimi të ndjeshëm në tarifat e aksesit bitstream do të çonte në rënie të interesit për përdorimin e inputeve të tjera me shumicë si aksesit në tubacione, dhe rrjedhimisht në konkurrencë më të ulët bazuar në infrastukturë;
- Skontoja prej 40% e përdorur në arsyetimin për të arritur në tarifat e reja me shumicë të Altelecom për aksesin bitstream krijon mundësinë për replikimin e produkteve dhe shërbimeve me pakicë të Altelecom për aksesin broadband.
- Niveli i ri i rishikuar për tarifat e Altelecom propozohet të hyjë në fuqi më datë 1.07.2017 si edhe përcaktimi në dokumentin e miratuar nga AKEP më datë 22.12.2017, dhe nuk krijon probleme për operatorët që kanë lidhur marrveshje me Altelecom për aksesin bitstream dhe për operatorë të tjerë që mund të lidhin marrveshje të reja me Altelecom për këto shërbime.
- Tendanca në vendet e BE është për derregullim të tarifave të aksesit bitstream dhe në kushtet kur në Shqipëri nuk ka pasur dhe nuk ende mosmarrveshje për tarifat e shërbimit të aksesit bitstream (palët kanë rënë dakort me tarifat e aplikuar nga Altelecom dhe së fundmi edhe për tarifat e Tetor 2016 janë nënshkruar amendamentete përkatëse midis Altelecom dhe operatorëve përfitues të këtij aksesit);
- Niveli i ri i propozuar i tarifave me shumicë të aksesit bitstream dhe LLU vlerësohet të krijojë stimujt e duhur edhe për Altelecom për investime në infrastrukturë dhe shërbime me shumicë të aksesit broadband.

Përvec ndryshimeve të cituara më sipër, përcaktimet e tjera të dokumentit “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse - Dokumenti Përfundimtar*” nuk ndryshojnë.

# Aneks 1: Pyetjet e këshillimit publik

---

Më poshtë është një përmbledhje e pyetjeve për të cilat AKEP është i interesuar të marrë komente nga palët e interesuara. Në përgjigjet e dhëna për pyetjet, palët janë të lutura të përfshijnë edhe argumentim për përgjigjet/komentet. Palët mund të japin komente edhe për pjesë të tjera të dokumentit dhe propozimeve të AKEP.

1. Cili është opinion juaj për argumentat e Albtelecom për rishikimin e tarifave të aksesit bitstream dhe LLU?
2. Cili është opinion juaj në lidhje me rishikimin e propozuar nga AKEP të tarifave të aksesit bitstream dhe LLU të Albtelecom:
  - i. A mundësojnë tarifave të propozuara me shumicë të aksesit bitstream marzh të mjaftueshëm dhe të duhur për operatorët përfitues të këtij aksesit për të konkurruar me Albtelecom në tregun me pakicë të aksesit broadband?
  - ii. A mendoni se niveli i ri tarifave të aksesit bitstream i shoqëruar me reduktimet e tarifave të aksesit në tubacione të Albtelecom krijojnë stimujt e duhur për përdorim të këtyre shërbimeve nga operatorët e tjerë dhe rritje të konkurrencës në tregun me pakicë të aksesit broadband?